

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Balla akuzon Berishën: Takove rusin që hartoi raportin kundër UÇK-së, punove kundër Hashim Thaçit(VI DEO)
ADRESA	https://dosja.al/politike/balla-akuzon-berishen-takove-rusin-qe-hartoi-raportin-kunder-u-k-se-puno-i514665
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 14:34:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 14:17:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	dac714aa02d464f5123b3ebb4f89efc16f89c03e839c130a563023ce897dab24
TEKSTI	668514737ab4ace191b609dedb335f8a443f9f24d67d3330311efd3aad644993
PAMJA	93fb09fe3696f7ead2d9d7c932cfacd04df8efc85e9cfccc920bd61ac668f740

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	eda4d43818d10f6f29ee453caa9a4151e7ba8f1bc36beedfc38da5c1de2166c2
E MËPARSHMJA	789ec1c093b24a3b57c97962ae46161e7a827f7da14fde9034b263cbdaddc48b
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/eda4d43818d10f6f29ee453caa9a4151e7ba8f1bc36beedfc38da5c1de2166c2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES ▾

2 ORE ME PARE

Vendimi i Hagës nxit protesta dhe reagime në Kosovë/ PDK mbledh Kryesinë, familjarët: Gjykatë kriminale, presim pafajësi në Apel

6 ORE ME PARE

Rrëzohet kërkesa e PD që të mos votohet drafti për pagat e magistratëve, Balla: Hipokrizi! Bardhi: Tërhiqeni ligjin

6 ORE ME PARE

"Nuk na përfaqësoni"/ Qytetarët protestojnë pranë Kuvendit, përplasen me policinë, shoqërohen disa prej tyre

21 ORE ME PARE

Dita e 109-të e protestës kundër Ramës, qytetarët rikthehen në shesh: Nesër protestë para Parlamentit

Politike

Balla akuzon Berishën: Takove rusin që hartoi raportin kundër UÇK-së, punove kundër Hashim Thaçit(VIDEO)

Balla tha se deklarata e përbashkët e Kuvendit për Kosovën ishte rezultat i një dakordësie mes forcave kryesore politike, por akuzoi drejtuesit e PD-së se po dilnin përtej këtij konsensusi për të drejtuar gishtin ndaj mazhorancës dhe kryeministrit Edi Rama.



17 Shtator 2026, 16:17
Nga E. D



Taulant Balla

TIRANË- Kryetari i Grupit Parlamentar të PS, Taulant Balla akuzoi opozitën se sot po kërkon t'i faturojë përgjegjësi politike qeverisë, ndërsa në vitin 2011 përfaqësues të saj mbështetën rezolutën e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës të ngritur mbi raportin e Dick Marty-t. Balla tha se deklarata e përbashkët e Kuvendit për Kosovën ishte rezultat i një dakordësie mes forcave kryesore politike, por akuzoi drejtuesit e PD-së se po dilnin përtej këtij konsensusi për të drejtuar gishtin ndaj mazhorancës dhe kryeministrit Edi Rama.

Sipas Ballës, opozita nuk mund të paraqitet sot si mbrojtëse e ish-drejtuesve të UÇK-së duke harruar qëndrimet e saj të mëparshme. Balla sulmoi drejtpërdrejt edhe Sali Berishën, duke pretenduar se kreu i PD-së kishte zhvilluar më herët takim me politikanin rus Konstantin Kosaçev. Sipas tij, megjithëse gjykata deklaroi se procesi nuk kishte të bënte me legjitimitetin e UÇK-së, mënyra se si u përshkruan strukturat dhe drejtuesit e saj krijoi një narrativë që, sipas Ballës, cenon portretin historik të luftës çlirimtare.

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

POLITIKE 17 SHTATOR 2026, 11:46

"Urime për look-un e ri"/ Muçi
ironizon deputeten socialiste,
Zegjine Çaushti i përgjigjet
ashpër: O psikopat, na hape
barkun

POLITIKE 17 SHTATOR 2026, 11:22

Me cigare në dorë/ Monika
Kryemadhi bashkëbisedon
me protestuesit para SPAK:
Bashkohuni dhe organizohuni
mes jush!

“Ramoviç jep dorëheqjen sa më parë!”/ Vijon protesta pranë Kuvendit, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama (VIDEO)

"I bashkohem falënderimit të Kryetarit të Kuvendit për dakordësinë që arritëm në deklaratën e sotme, shenjë pjekurie politike dhe përgjegjësie të madhe të grupeve më të mëdha politike të përfaqësuara në Kuvend. Edhe pse, t'ju them të drejtën, e kërkoja fjalën tani për të evidentuar diçka që e vlerësoj se e prish mesazhin e kësaj seance. Shoh që lidhshipi politik i Partisë Demokratike, të gjithë sekretarët me radhë, marrin fjalën, dalin përtej deklaratës së përbashkët dhe drejtojnë edhe gishtin për fajësi, drejtojnë edhe gishtin për përgjegjësi politike të mazhorancës, të kryeministrit, edhe pse besoj që bien të gjithë dakord që nuk ka një ndër ne, 140 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, që ka luftuar më shumë për pafajësinë e çlirimtarëve ai quhet Edi Rama.

Besoj që bien dakord të gjithë për këtë. Dhe në anën e kundërt të historisë, edhe të këtij fakti, nuk ka një person që besoj edhe këtu bien të gjithë dakord që të paktën ndaj Hashim Thaçit ka qenë më agresiv, ka qenë më i dëmshëm, është Sali Berisha. Sepse e dini fare mirë deklaratën e tij publike, se Thaçi duhet të shkojë në Hagë ku duhet të pastrohet. Në vitin 2020. Është deklaratë e kryetarit aktual të Partisë Demokratike dhe të përhershëm të asaj që ka mbetur nga Partia Demokratike. Dhe për ta mbyllur këtë dialektikë, i vetmi në këtë sallë ndër ne, 140, që e ka takuar iniciuesin, shkruesin e raportit mbi të cilët u ngrit kjo gjykatë, rusin Konstantin Kosaçev, në këtë sallë, ai quhet Sali Berisha.

Nuk ka një të dytë ndër ne këtu që ta ketë takuar Konstantin Kosaçevin, të paktën nga faktet publike. Dhe e ka takuar në dimrin e vitit 2010, vetëm pak ditë, 40 ditë nga 25 janar të vitit 2011, kur është votuar rezoluta në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës, ku kjo parti, si gjithmonë në historinë e vet, ka qenë në anën e duhur të historisë, ndërkohë që ju keni votuar në 25 janar 2011 rezolutën në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës për për rezolutën që ngriti gjykatën në Kosovë. Prandaj, këtu, të ju lutem shumë, këto teatrot, se ju jeni atdhetarët, se ne qenkemi tradhtarët, lëreni për një kohë tjetër.

E kemi ndjekur me shumë shqetësim, po, të gjithë, shpalljen e aktgjykimit të shkallës së parë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, nga ato dhoma të specializuara të Kosovës në Hagë. Prej dje, sot, nesër, e çdo ditë, në vijim edhe të kësaj deklarate të përbashkët, na duhet të mos heshtim përballë gjuhës me të cilën u përshkruan "lufta për liri", "gjaku i dëshmorëve", "roli i komandantëve dhe pjesëtarëve të ushtrisë çlirimtare të Kosovës".

Gjykatësi e deklaroi që në fillim se procesi nuk kishte të bënte me legjitimitetin e UÇK-së dhe me qëllimin për një Kosovë të pavarur, mirëpo e tradhtoi vetja rugës, dhe aktgjykimi na ndërtoi një akt rrefimi tjetër, të gjerë dhe poshtërues, në të cilin kufiri ndërmjet përgjegjësisë individuale dhe karakterit të luftës çlirimtare u bë pothuajse i padukshëm. Kur drejtuesit kryesorë politikë dhe ushtarakë të një lëvizje çlirimtare përshkruhen si pjesë e një qëllimi të përbashkët, një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale, kur komunikatat, organizimi politik, strukturat e sigurisë dhe vetë veprimtaria politike e saj u paraqiten si mjete të këtij qëllimi kriminal, atëherë nuk kemi aspak të bëjmë me një gjykim të veprimeve të caktuara të katër komandantëve.

Dhe gjykatësi, në kundërshtim me mandatin e vet gjykues, bëri deklarata politike me qëllimin e qartë të ndryshimit keqdashës të portretit historik të UÇK-së. Dje u munduan të na bëjnë një portret tjetër të UÇK-së që dimë, që njohim, dhe që respektojmë përjetësisht. Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk lindi siç tha gjyqtari për pushtet politik dhe as për të ndërtuar një ndërmarrje kriminale. Ajo lindi si përgjigje ndaj represionit shtetëror serb, dëbimeve, burgosjeve, masakrave dhe mohimit të gjatë të lirisë së shqiptarëve të Kosovës.

Kjo është e vërteta historike. Lufta e saj ishte luftë për çlirim, për mbijetesën e një populli të cilit i ishte mbyllur çdo rrugë paqësore drejt lirisë. Krimet e kryera nga forcat shtetërore paramilitare serbe kundër shqiptarëve të Kosovës, zonja e zotërinj, motra e vëllezër, nuk mund të jenë kurrsesi sfond dekorativ i kësaj historie. Ato ishin arsyeja themelore pse ajo luftë filloi. NATO nuk ndërhyri në Kosovë kundër një populli që po përpiqej të ndëronte një ndërmarrje kriminale, se me atë vendim i bie që NATO të konsiderohet bashkëpunëtorë e një organizate—e një ndërmarrjeje kriminale, paska mbështetur dhe ka vepër penale edhe në legjislacionin e Kosovës, që ta bëjë me faj edhe NATO-n.

Ajo ndërhyri për të ndaluar një katastrofë humanitare, për të mbrojtur një popull të kërcënuar në dëbim e shfarosje. Prandaj është e papranueshme ajo batërdi që dëgjuam e që të cilët duhet ta marrim të plotë, sepse aty përmendet shpesh edhe Shqipëria, dhe nuk duhet përdorur dhimbja e viktimave për të ndërtuar një rrefim që errëson dallimin historik ndërmjet agresorit shtetëror dhe popullit që luftoi për liri. Prandaj, Dhomat e Specializuara u krijuan me ligjet miratuara në Kosovë, ato ushtrinë juridiksionin e tyre në emër të rendit juridik të Kosovës. Megjithatë, katër udhëheqësit e UÇK-së janë shpallur dje fajtorë përmes një përshkrimi historik në të cilin, sipas tyre, Kosova nuk e njihte historinë e vet.

më të klikuarat

81 vite burg për katër ish-krerët e UÇK-së/ Nga kërkesat ndërkombëtare te vota e Kuvendit/ Si u ngrit Gjykata Speciale në Hagë? Rama me helikopter drejt Prishtinës për të kërkuar votat pro

Të shtënat me armë në Durrës/ I plagosur mbeti një avokat, policia në kërkim të autorit (EMRAT+PAMJET)

Regjistruan 1143 hektarë me dokumente fals/ Arrestohen dy ish-drejtorë dhe juristi i ASHK Fier, në pranga edhe një punonjës (EMRAT)

Kontrolle në burgjet e Peqinit dhe Fierit/ Kapen celularë, arrestohet një i burgosur dhe procedohen 9 persona

insights

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka
Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Populli i Kosovës e di pse nisi lufta, e di kush e solli dhunën, kush e dogji vendin, kush i dëboi qytetarët nga shtëpitë e tyre dhe kush i mbushi varrezat. Dhe këtu po bëj thjesht e vetëm një krahasim mes katër zyrtarëve, gjashtë zyrtarëve të Serbisë të dënuar nga Haga dhe katër çlirimtarëve të UÇK-së të shpallur në shkallën e parë fajtorë nga Haga. Dhe po i marr me radhë vendimet e Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, e cila ka dënuar gjashtë zyrtarë të lartë serbë jugosllavë për krimet e kryera në Kosovë gjatë vitit 1999.

I pari ishte Slobodan Millosheviç, i cili nuk u dënua, sepse e dënoi Perëndia përpara se ta dënonte gjykata. Por i dyti në radhë ishte zëvendëskryeministri Nikola Shajinoviç, i cili u dënua me vetëm 18 vite burg, edhe pse mbi të, bashkë me të tjerët më poshtë, rëndonin të paktën 12,000 të vrarë, 1,600 të plagosur, 20,000 vajza dhe gra të përdhunara dhe 500,000 qytetarë të tjerë të shpërngulur. Është dënuar me 18 vite burg.

I dyti, Nebojsa Pavkoviç, komandanti i armadës së tretë jugosllave, që u dënua me 22 vite burg. I treti, Sreten Lukić, drejtuesi i strukturave të MUP-it serb, me 20 vite. I katërti, Vladimir Lazareviç, komandanti i korpusit të Prishtinës, autor kryesor, vetëm 14 vite. Dhe Hojdaniqi, shefi i shtabit të përgjithshëm, me 15 vjet, dhe Xhorxheviqi, me 18 vjet, ish-zëvendësministri i brendshëm i fokusuar në Kosovë. Mjafton. Mjafton për të kuptuar që ai vendi i djeshëm nuk ka asnjë emër tjetër veçse turp, marre i thonë Kosovë, tha Balla./Dosja.al

taulant balla

Sondazh

Poll



Politike

17 Shtator 2026, 16:03

Vendimi i Hagës për ish-krerët e UÇK-së/ Spiropali: UÇK u ngrit për të mbrojtur gratë e dhunuara dhe fëmijët

Elisa Spiropali TIRANË- Ish-ministrja e Jashtme Elisa Spiropali ka reaguar pas dënimit të ish-krerëve të UÇK-së nga Gj...

Berisha takon ish-kryeministrin e landit të Turingisë, Dieter Althaus dhe Thomas Kunze: Narkoshteti i kryesuar nga Edi Rama është problemi më madhor i Shqipërisë

Politike

17 Shtator 2026, 15:53



Vendim i Hagës për ish-krerët e UÇK-së/ Kuvendi i Shqipërisë del me deklaratë të nërhashkët: Lufta e UÇK-së ishte lufta e

një populli për çlirim

Politike

17 Shtator 2026, 15:15



"Evis Sala ka qenë studiuese e rrallë"/ Berisha lavdëron ish-Ministren, thirrje Spahiut: Shko e pi kafe me Karçanajn të mbledhësh mendjen!

Politike

17 Shtator 2026, 14:46



"KAYO skandal i paparë"/ Berisha: Bëhet trafik armësh, e shëmtuar për një vend të NATO-s

Politike

17 Shtator 2026, 14:42

Politike

17 Shtator 2026, 14:41

Kërkoj pezullimin e afateve të paraburgimit, rrëzohet kërkesa për lirin e Ilir Metës

Apeli i Posaçëm ka rrëzuar kërkesën e Ilir Metës, i cili kishte kundërshtuar vendimin e shkallës së parë p...

"E qepi gojën"! Berisha për Ramën pas vendimit të Hagës: I futi thikën pas shpine Kosovës

Politike

17 Shtator 2026, 14:35

"O e sjell PET Scan-in, o jap dorëheqjen"/ Spahiu bën premtimin në Kuvend: Në janar 2027 do të jetë në Onkologjik

Politike

17 Shtator 2026, 13:33

Pas dënimit të ish-krerëve të UÇK-së,
Haga hap procedurën për
dëmshpërblimin e viktimave

Politike

17 Shtator 2026, 13:07

Boçi: Shkollat me më pak se 21 nxënës u
përfshytuan nga PISA 2025. Kumbaro:
Përzgjedhja e shkollave sipas
metodologjisë së OECD-së

Politike

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.